

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Sabri Rrapi,	Anëtar i“ “
Zija Vuci,	Anëtar i“ “
Alfred Karamuço,	Anëtar i“ “
Kristofor Peçi,	Anëtar i“ “
Bardha Selenica,	Anëtar i“ “
Kujtim Puto,	Anëtar i“ “
Sokol Sadushi,	Anëtar i“ “
Hajredin Fuga,	Anëtar i“ “

me sekretare Arbenka Lalica, më datë 26.06.2000, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.42, Akti që i përket:

KËRKUES: ZYDI ELEZI, i përfaqësuar nga avokati Sokol Agolli, me prokurë.

O B J E K T I:

Shfuqizimin e vendimit nr.239, datë 23.06.1999 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e vendimit të sipërcituar të kolegjit penal të Gjykatës së Lartë.

- Është shkelur neni 414 i Kodit të Procedurës Penale sepse akti i rekursit të prokurorit të Apelit nuk i është komunikuar të pandehurit apo avokatit të tij, gjë që del qartë nga aktet e dosjes.

Mosrespektimi i këtij detyrimi, ka sjellë si pasojë që i pandehuri të mos ushtrojë të drejtën për t’u dëgjuar para kolegjit penal, duke u shkelur neni 33 pika 1 e Kushtetutës.

Shkelja e të drejtës kushtetuese për t’u dëgjuar e bën procesin ligjor jo të rregullt, në kuptim të nenit 42 pika 1 e Kushtetutës.

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi përfaqësuesin e kërkuesit, që u shpreh për pranimin e kërkesës dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

Kërkuesi Zyhdi Elezi, me vendimin nr.1, datë 05.01.1999 të gjykatës së rrethit Kavajë, është dënuar me 13 muaj burgim për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 290/1 dhe 273 të Kodit Penal.

Gjykata e Apelit Durrës, mbi ankimin e të pandehurit të ushtruar nëpërmjet mbrojtësit të emëruar nga të afërmit e tij, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit dhe pezullimin e ekzekutimit të vendimit, konform nenit 59 të Kodit Penal për një kohë prej dy vjetësh.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës, ka ushtruar rekurs prokurori pranë Gjykatës së Apelit Durrës dhe kolegji penal i Gjykatës së Lartë, pa prezencën e mbrojtësit të të pandehurit, me vendimin nr.239, datë 23.09.1999 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës me ndryshimin që revokohet pezullimi i ekzekutimit të këtij vendimi.

Nga materialet e dosjes rezulton se nuk ka asnjë dokument apo veprim që të vërtetojë se të pandehurit apo mbrojtësit të tij, t’i jetë komunikuar rekursi i ushtruar nga prokurori pranë Gjykatës së Apelit Durrës. Në këtë mënyrë, është vepruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 414 të Kodit të Procedurës Penale në të cilin shprehet “Akti i ankimit u njoftohet prokurorit, të pandehurit dhe palëve private nga sekretaria e gjykatës që ka dhënë vendimin”. Duke mos u përmbushur ky detyrim ligjor, të

pandehurit nuk i është dhënë mundësia që të dijë se çështja e tij do të shqyrtohet nga Gjykata e Lartë dhe njëkohësisht të dëgjohet e të mbrohet, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, rreth parashtrimeve të bëra nga prokurori në rekursin e tij. Mohimi i të drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, përbën shkelje me karakter kushtetues, të cilat e bëjnë procesin ligjor jo të rregullt, në kuptim të nenit 42 pika 1 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131 germa “f” dhe 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe të neneve 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.239, datë 23.06.1999 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim po kësaj Gjykate.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 18.07.2000
Nr.42 i Regj.Themeltar
Nr.44 i Vendimit